



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 262, Datë 21.10.2025

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “VIVID POWER” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “ç” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2467/7 prot., datë 16.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “Vivid Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Vivid Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2467 prot., datë 17.09.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 244, datë 30.09.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.10.2025 dhe 02.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua po ashtu në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 2467/5 prot., datë 03.10.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2467/6 prot., datë 10.10.2025, ka depozituar informacionin/dokumentacionin e konstatuar të munguar të këtij aplikimi.

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar.

- Në referencë të përcaktimeve të rregullores, aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për nenin 9, pika 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe për pikën 2.4, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
- Për sa njoftuar nga vetë shoqëria se sistemi IT dhe stafi teknik në strukturën e saj organizative do të bëhen efektive pas licencimit dhe përpara fillimit të aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike, vlerësohet që t’i lihet kusht asaj që me fillimin e operimit, të depozitojë në ERE informacionin e përditësuar për sistemin IT dhe strukturën organizative me stafin teknik efektiv për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria i disponon aktualisht zyrat përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i kontratës së huapërdorjes përfundon më 04.01.2026 dhe nuk mbulon afatin 5-vjeçar të licencës, vlerësohet t’i lihet kusht asaj që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të huapërdorjes për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara, ndaj bordi i ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Me fillimin e operimit, shoqëria të depozitojë në ERE informacionin e përditësuar në lidhje me sistemin IT dhe strukturën organizative me stafin teknik efektiv për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.
3. Brenda datës 04.01.2026, shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të huapërdorjes për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3.
5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI